



AKT THEMELIMI

Krijohet ne Shqiperi Shoqeria me Pergjegjesi te Kufizuar Deloitte & Touche, prej Ortakut te vetem Deloitte & Touche Eastern Europe S.A., perfaqesuar prej z.Trevor J. Wallinger, shtetas britanik, me banim ne Republiken Ceke, me adrese Nove Domy 67, Predni Kopanina, 164 00 Praha 6, identifikuar me leter njoftimin No. B 464159, ne baze te vendimit ne takimin e dates 15 Janar 1996 te Bordit te Shoqerise Deloitte & Touche Eastern Europe S.A.

Kjo Shoqeri krijohet ne perputhje te plote me legjislacionin Shqiptar per Shoqerite Tregtare, konkretisht Ligji 7638, date 19.11.1992, Ligji 7764, date 02.11.1993 "Per Investimet e Huaja ne Republiken e Shqiperise"; Ligjit Nr. 7667, date 28.01.1993 "Per Regjistrin Tregtar dhe Formalitetet qe Duhet Respektuar nga Shoqerite Private".

1. Objekt i aktivitetit te kesaj Shoqerie do te jene:
 - (a) kontroll-revizionim dhe kontabilitet
 - (b) sherbime per taksat
 - (c) konsulence menaxheriale
 - (d) finance korporatash
 - (e) cdo sherbim tjeter qe lidhet me to
2. Kjo Shoqeri krijohet per te ushtruar nje aktivitet mbi dhjete vjet.
3. Kapitali themelor do te jete 100,000 Leke. Ky kapital eshte i derdhur teresisht nga Ortaku themelues.
4. Selia e kesaj Shoqerie do te jete: Tirana Trade Center, Nr.32, Rruga e Durresit, Tirana - Shqiperi. Kjo Shoqeri mund te hape filiale, agjensi ose vendqendrim te tjera te dyta ne te gjithë territorin e Shqiperise ose dhe jashte saj sipas legjislacionit perkates.
5. Administratori (Presidenti) i Shoqerise eshte z. Trevor J. Wallinger,
6. Duke u mbeshtetur ne dispozitat e statutit te Shoqerise, kjo shoqeri ne punesimet eventuale qe mund te kryej merr persiper rrespektimin e legjislacionit Shqiptar ne fushen e marredhenieve te punes.
7. Ky akt themelimi perpilohet ne pese kopje ne shqip dhe pese anglisht me vlere te barabarte secila, dhe pasi gjendet sipas vullnetit te themeluesit te shoqerise nenshkruhet pa verejtje prej tij.

Administaratori

Trevor Wallinger

1. DISPOZITA TE PERGJITHSHME

1.1 "Deloitte & Touche" SH.P.K. (qe tani e mbrapa do i referohemi si "Shoqeria") eshte nje shoqeri me investim te huaj qe eshte themeluar dhe do te veproje ne perputhje me ligjet e Republikes se Shqiperise Nr.7638, date 19.11.1992 "Per Shoqerite Tregtare"; Nr. 7764 date 02.11.1993 "Per Investimet e Huaja ne Republikën e Shqiperise"; Ligjit Nr. 7667, date 28.01.1993 "Per Regjistrin Tregtar dhe Formalitetet qe Duhën Respektuar nga Shoqerite Private"; dhe ne perputhje me kete Statut.

1.2 Adresa e shoqerise do te jete:

Tirana Trade Center, Nr. 32, Rruga e Durrësit, Tirana, Shqiperi

1.3 Objekti i veprimtarise se Shoqerise do te jene aktivitetet qe vijojne:

- (a) kontroll-revizionim dhe kontabilitet
- (b) sherbime per taksat
- (c) konsulence menaxheriale
- (d) finance korporatash
- (e) cdo sherbim tjeter qe lidhet me to

1.4 Shoqeria, me vendim te Ortakut, mund te angazhohet edhe ne aktivite te tjera sipermarrese me dhe te cilat nuk jane te ndaluara me ligj. Shoqeria nuk do te filloje ndonje aktivitet sipermarres qe kerkon licence nga autoritetet shqiptare, deri ne kohen kur nje licence e tille te jete e vlefshme ne Regjistrin e Shoqerive te Republikes se Shqiperise (Regjistri).

1.5 Shoqeria do te kete te drejtat e nje personi juridik, dhe mund te kete llogarinet (te) e saj bankare dhe vulen e Shoqerise. Nen emrin e saj, Shoqeria ka te drejte te zoteroje, bashkoje dhe transferoje prona dhe te drejta personale jo ne pronesi; mund te marre mbi vete detyrime; ka te drejte te pretendoje dhe te pergjigjet perpara ligjit, arbitrazhit dhe institucioneve te autoriteteve te administrates shteterore.

1.6 Shoqeria do te kete te drejta te plota pronesie per sa i perket pronave te saj, dhe prona e Shoqerise nuk mund te konfiskohet ose te tjetersohet ne ndonje menyre tjeter nga mjetet e administrates shteterore.

1.7 Shoqeria do te jete pergjegjese per detyrimet qe perfshijne cdo gje qe lidhet me pronen e saj.

1.8 Ortaku do te jete pergjegjes per detyrimet e shoqerise vetem per sa i perket investimit te tij ne Kapitalin e Kontributeve te Shoqerise. Asnje prone tjeter e Ortakut nuk do te jete subjekt i detyrimeve te Shoqerise.

1.9 Shoqeria nuk do te jete pergjegjese per detyrimet personale te Ortakut.

1.10 Koha e egzistences se Shoqerise do te jete e perhereshme por te pakten per 10 vjet.

Trevor J. Wallinger





1.11 Shoqeria mund te vendose filiale dhe zyra perfaqesuese, dhe mund te marre pjese ne themelimin e ndermarrjeve te tjera, ne Republiken e Shqiperise dhe jashte saj.

1.12 Shoqeria do te kete te drejte ndaj te gjithe taksave dhe detyrimeve lehtesuese te vendosura me ligjin "Mbi Investimet e Huaja ne Republiken e Shqiperise" dhe ne cdo ligj tjeter te zbatueshem, mbi cdo praktike dhe regull qeveritar, dhe mbi traktatet dhe marreveshjet nderkombetare.

2. ORTAKU I SHOQERISE

2.1 Themeluesi dhe Ortaku i vetem i Shoqerise eshte:

Deloitte & Touche Eastern Europe SA, nje Shoqeri egzistuese dhe e themeluar sipas ligjeve te Belgjikes, regjistruar ne Regjistrin Tregtar te Brukselit me date 10.08.1990, me numer 535255.

Ortaku eshte i perfaqesuar nga Zoti Trevor J. Wallinger, Drejtori i pergjithshem i Deloitte & Touche Eastern Europe S.A.

2.2 Sipas faktit qe shoqeria eshte themeluar ne perputhje me ligjin "Mbi Investimet e Huaja ne Republiken e Shqiperise", Ortaku ka te gjithe te drejtat e dhena investitoreve te huaj nen legjislacionin shqiptar, duke perfshire por jo kufizuar te drejtat qe vijojne:

- (a) te emeroje Drejtorin e Pergjithshem;
- (b) te marre nje certifikate kontributesh qe perfaqeson investimin e Ortakut ne Kapitalin e Kontributeve te Shoqerise;
- (c) te marre devident te cilat mund te paguhen ne monedhe te huaj te konvertueshme dhe mund te transferohen jashte shtetit, sipas kerkeses se Ortakut;
- (d) me likuidimin e Shoqerise, ose duke ndjekur nje renie te Kapitalit te Kontributeve, te marre pjesen e kapitaleve te Shoqerise qe korespondojne me pjesen e kontributeve te Ortakut ne Shoqeri ne monedhe te huaj te konvertueshme; kapitale te tilla mund te transferohen jashte shtetit me kerkesen e Ortakut;
- (e) ti kerkoje drejtuesve te Shoqerise per ti dhene informacion per Shoqerine dhe aksivitetet e saj dhe ti lejojte hyrje ne te gjithe dokumentet e Shoqerise;
- (f) te drejtat te tjera qe nuk jane ne konflikt me kete Statut dhe ligjet e Republikes se Shqiperise.

2.3 Ortaku do te kete detyrimet e qe vijojne:

- (a) te investoje pjesen e tij te Kapitalit te Kontributeve sic pershkruhet ne kete Statut;
- (b) te observoje te gjithat termat dhe kushtet e ketij Statuti.

2.4 Persona fizik dhe entitete te tjera ligjore mund te pranohen si pjesmarres shtese, duke siguruar se pjesmarres te tille shtese bien dakort te njohin dhe te jene te kufizuar nga te gjitha termat dhe kushtet e kesaj Statuti.

2.5 Udhezimet sipas te cilave ortaket e tjere jane te pranuar ne Shoqeri, duhet te aprovohen nga Ortaku. Pavec te tjerave, udhezime te tilla duhet te pershkruajne:

- (a) Cdo rritje te Koutes se Kontributeve, dhe masen e kesaj rritjeje;

Trevor J. Wallinger

- (b) shumën e Kuotes së Kontributeve dhe numrin e kontributeve në qarkullim të Shoqërisë, si para edhe pas pranimit të pjesëmerrësve të tjerë;
- (c) vlerën e çdo kuote të Shoqërisë;
- (d) çdo të drejtë të refuzimit të pare të ortakëve;
- (e) afatin brenda të cilit ortakët shtesë duhet të paguajnë për kuotat e nënshkruara;
- (f) datën në të cilën ortakëve shtesë do t'u jepet e drejta ndaj kuotave për dividendin e Shoqërisë.

3. KUOTA E KONTRIBUTEVE DHE PJESA E ORTAKUT

3.1 Kuota e Kontributeve do të konsistoje në kapitalin e investuar nga Ortaku si pagesë për kuotat e nënshkruara, dhe ajo pjesë e fondeve të akumuluarat të Shoqërisë që Ortaku mund të zgjedhë për të kontribuar për Kapitalin.

3.2 Në kohën e regjistrimit të Shoqërisë tek Regjistri, shuma e Kapitalit themelor të tij është 100,000 (njëqind mijë) Leke. Kapitali fillestar është investuar në dollarë amerikan sipas kursit të kembimit të Bankës së Shqipërisë në datën e investimit të kapitalit, sipas mënyrës së përcaktuar në ligjin "Mbi Investimet e Huaja në Republikën e Shqipërisë".

3.3 Vlera e çdo kuote do të jetë 10,000 (dhjetë mijë) leke, që mund të kontribohen në mënyrë të plote ose të pjesëshme në formë monetare, materiale ose kapitale të tjera jo-monetare.

3.4 Në kohën e regjistrimit të Shoqërisë tek Regjistri, Kapitali i tij themelohet do të përbehet nga kontributet e mëposhtme të nënshkruara dhe të paguara nga Themeluesi dhe Ortaku i vetëm:

Deloitte & Touche Eastern Europe SA, - 10 (dhjetë) kuota

3.5 Çdo kuota do të përfaqësojë një votë dhe të drejtën për të marrë pjesë në shpërndarjen e përfitimeve të shoqërisë.

3.6 Ortaku ka të drejtën e një certifikate kuotash që përfaqëson numrin e kuotave të zotëruara nga ai. Certifikatat e kuotave duhet të jenë në formën e përshkruar nga Ministria e Drejtësisë e Republikës së Shqipërisë.

3.7 Certifikatat e Kuotave mund të nxirren në mbizotërim të 1, 5, 10 50 dhe 100 kuotave.

3.8 Certifikatat e kuotave duhet të nxirren në një kopje të vetme dhe të mbahen në zotërim të Ortakut.

3.9 Informacioni në lidhje me pronësinë e kuotave, do të jenë të regjistruara në Librin e Ortakëve dhe Kuotave të Shoqërisë, si dhe në Regjister në bazë të ligjeve të Republikës së Shqipërisë.

3.10 Kuotat mund të transferohen tek Ortakët e tjerë sipas termave dhe kushteve të vendosura nga shitësi dhe transferuesi, në përputhje me këtë Statut dhe ligjin Shqiptar.

Trevor J. Wallinger





3.11 Transferimi i pronësive së një kuote duhet të tregohet me saktësi në Librin e Ortakëve dhe Kuotave të Shoqërisë, si dhe në Regjistrin.

3.12 Ortaku i ri duhet të pranohet nga Shoqëria me të drejtat dhe detyrimet e Ortakut.

3.13 Dividentet që nuk janë tërhequr nga Shoqëria për një periudhë që kalon 3 (tre) vjet do të behen prona e Shoqërisë, me përjashtim të atyre rasteve kur kjo periudhë do të përcaktohet si ndërprerje ose i humbur. Shoqëria nuk do të ketë asnjë detyrim për të paguar interesat mbi dividendet që nuk janë tërhequr nga Shoqëria.

4. RITJA DHE ZVOGELIMI I KAPITALIT THEMELOR

4.1 Rritja ose zvogelimi i Kapitalit të Themelor do të lejohet vetëm me vendim të Ortakut, dhe pas ndryshimit të duhur të Statutit dhe regjistrimit të ndryshimeve të tilla me Regjistrin.

4.2 Ortaku duhet të vendosë termat dhe kushtet për rritjen dhe zvogelimin e Kapitalit Themelor në përputhje me ligjin shqiptar.

4.3 Kapitali Themelor mund të rritet në formën e investimeve shtesë brenda Shoqërisë:

- (a) kur Shoqëria nxjerr kuota shtesë, për tu nënshkruar dhe paguar nga Ortaku, dhe/ose
- (b) kur Shoqëria nxjerr kuota shtesë, për tu nënshkruar dhe paguar nga ortakët e tjerë, dhe/ose
- (c) kur ortakët investojnë duke rritur vlerën nominale të çdo kuote të Kapitalit Themelor.

4.3.1 Kapitali Themelor mund të rritet edhe në qoftë se si rezultat i aprovimit të raportit vjetor ose një bilanci të vecantë, fonded e akumuluar të Shoqërisë e kapërcejnë shumën e Kapitalit Themelor. Pastaj ortakët mund të vendosin të rinvestojnë fondin e akumuluar tek Kapitali Themelor. Pastaj, sipas rregullit të vendosur nga Ortaku, rritja e Kapitalit Themelor mund të reflektohet duke ngritur vlerën nominale të çdo kuote të Kapitalit Themelor.

4.4 Në rastet kur secila prej kuotave shtesë nuk është paguar plotësisht në kohën e përcaktuar nga Ortaku, Ortaku mund të vendosë që Kapitali Themelor do të rritet me shumën që është kontribuar aktualisht, ose që kontributet aktuale monetare, materiale ose jo-monetare do të kthehen dhe nuk është bërë rritje në Kapitalin Themelor.

4.5 Kapitali Themelor mund të zvogelohet (por jo më pak se 100,000 Leke) sipas mënyrës që vijon:

- (a) duke ulur vlerën nominale të kuotave egzistuese;
- (b) nga anulimi i kuotave të Ortakut me qëllim të zvogelimit të Kapitalit Themelor.

Trevor J. Wallinger

5. ORTAKU

5.1 Ortaku do te jete trupi drejtues suprem i Shoqerise. Ortaku duhet te plotesoje te gjithë funksionet e Mbledhjes se Ortakeve dhe ka te gjitha te drejtat qe i vishen nje Mbledhjeje Ortakesh sipas legjislacionit Shqiptar.

5.2 Ortaku do te kete kompetenca ekskluzive per sa i perket ceshtjeve qe vijojne:

- (a) amendamente ose shtesa te ketij Statuti;
- (b) ritje ose zvogelim te kapitalit Themeltar;
- (c) nxjerrjen e kuotave te reja;
- (d) aprovimi i raporteve vjetore dhe i raporteve te tjera;
- (e) shperndarjen e fitimit;
- (f) emerimin dhe largimin e Drejtorit te Pergjithshem;
- (g) caktimin dhe pushimin e kontroll-revizionuesve;
- (h) riorganizimin ose likuidimin e Shoqerise
- (i) te filloje themelimin e zyrave vartese dhe krijimin e zyrave perfaqesuese;
- (j) asistencë ne materiale, hua me ose pa interes, dhe asistencë tjeter nga Shoqeria ndaj nje Ortaku ose Drejtorit te Pergjithshem.

5.3 Ortaku duhet te adresoje cdo vit ceshtjet qe vijojne, qe kerkohen te adresohen nga nje Mbledhje Ortakesh, sipas ligjit mbi "Shoqerite Tregtare", jo me vone se 4 (kater) muaj pas kalimit te vitit fiskal te Shoqerise:

- (a) aprovimin e raportit te Drejtorit te Pergjithshem, bilancin vjetor dhe llogarite me fitim e humbje;
- (b) shperndarjen e fitimeve te Shoqerise;
- (c) caktimin e kontroll-revizionuesit;
- (d) ceshtje te tjera te Shoqerise brenda kompetences se Mbledhjes se Ortakeve.

6. ZYRTARET

6.1 Zyrtaret e Shoqerise do te perbehen nga Administratori dhe nga zyrtare te tjere qe mund te emerohen nga Ortaku. Cdo zyrtar duhet te qendroje ne detyre deri sa pasardhesi i tij te zgjidhet dhe te kualifikohet ose me njoftimin e pare te shkarkimit nga detyra. I njejt person mund te drejtoje disa zyra njehersh.

6.2 Administratori do te jete zyrtari ekzekutiv kryesor i Shoqerise. Si subjekt i kushteve te ketij Statuti, Administratori do te kete pergjegjesine per menaxhimin dhe kontrollin teresor te biznesit dhe puneve te Shoqerise, do te kryej te gjithë detyrat dhe do te kete te gjithë fuqite qe jane karakteristike e zakoneshme per zyren e ekzekutuesit kryesor te shoqerise.

6.3 Administratori do te kete fuqine per te firmosur te gjithë kontratat e zakoneshme dhe instrumentat e tjere te Shoqerise, kontratat e jashtezakoneshme dhe instrumentat e tjere te Shoqerise. Administratori do te kete mbikqyrje te pergjithshme dhe drejtim te te gjithë zyrtareve,

Trevor J. Wallinger



pubonjesve dhe agjenteve te tjere te Shoqerise dhe te gjithë aktivitetëve te Shoqerise, pervec
cashijeve qe vijojne qe kerkojne autorizim te shkruar nga Ortaku:

- (a) Ekzekutimin e cdo forme marrveshje te Shoqerise per detyrime financiare qe kalojne 50,000
Leke ose afersisht e barabarte;
- (b) marrjen persiper te credive ne emer te Shoqerise;
- (c) hapjen dhe mbylljen e llogarive bankare.

6.4 Administratori i Deloitte & Touche SH.P.K. do te jete z. Trevor J. Wallinger.

7. RAPORTET VJETORE , BILANCET

7.1 Shoqeria do te organizoje mbajtjen e llogarive, financen dhe raportet statistikore si
dhe te pergatise dhe dorezoje raportet vjetore dhe bilancin, ne perputhje me ligjet dhe regullat e
tanishme te Republikes se Shqiperise.

7.2 Viti fiskal i Shoqerise do te jete nga 1 janar deri me 31 dhjetor.

7.3 Raportet vjetore, raportet e tjera dhe bilanci i Shoqerise do te pergatiten nga Drejtori i
Pergjithshem. Cdo raport vjetor duhet te permbaje te specifikuar te ardhurat dhe shpenzimet te
shpjeguara per cdo transaksion, nje table e te ardhurave the shpenzimeve, ndryshimet e ortakeve,
si dhe informacion tjeter qe lidhet me gjendjen financiare te Shoqerise.

8. LIKUIDIMI I SHOQERISE

8.1 Shoqeria do te likuidohet si vijon:


- (a) Me vendimin e Ortakut;
- (b) me vendimin e nje gjygji ose arbitrazhi qe ka autoritetin ligjor per te marre vendime te tilla;
- (c) ne rast deshtimi nga Shoqeria per te filluar veprimet brenda 1 (nje) viti nga data e regjistrimit
tek Regjistri;
- (d) ne se urdherohet nga Republika e Shqiperise per shkelje te ligjeve shqiptare nga Shoqeria;
- (e) si dhe per shkaqe objektive (force madhore, gjendje e jashtezakonshme) etj.

8.2 Ortaku do te caktoje likuiduesin dhe do ti jape te drejte te caktoje nje likuidues te ri
ne cdo kohe.

8.3 Me emerim te likuidatorit, i gjithë autoriteti i zyrtareve te Shoqerise ne lidhje me
Shoqerine te do te nderpritet. Megjithate, sigurohet se detyrimet dhe pergjegjesia e zyrtareve do
te vazhdoje deri ne nje kohe kur likuidimi i Shoqerise do te perfundoje.

8.4 Likuiduesi do te drejtoje likuidimin e Shoqerise ne perputhje me legjislacionin e
Republikes se Shqiperise.

Trevor J. Wallinger



10.3 Nje flete marrje-ne-dorezim per cdo kerkese, shenim, kerkese ose komunikim tjetër firmosur nga Ortaku, Drejtori i Pergjithshem, zyrtari apo punonjesi perkates, perpara ose pas kes se ngjarjes per te cilen eshte bere njoftimi, do te gjykohet ekuivalent me njoftimin qe i duhej dhene Ortakut, Drejtorit te Pergjithshem, zyrtarit, punonjesit apo agjentit. As per rendin e dites as per arsyen e ndonje mbledhjeje nuk ka nevoje te perdoret nje flete e tille.

10.4 Ortaku dhe zyrtaret e Shoqerise mund te drejtojne cdo mbledhje me ane te telefonit ose paisjeve te ngjashme te komunikimit, ku te gjithë pjesemarrësit ne mbledhje e degjojne njeri-tjetrin. Ne mbledhje te tilla, pjesmarrës te tilla do te percaktojne prezencen e tyre.

10.5 Firmosja e fakseve te cdo Ortaku ose zyrtari te Shoqerise, mund te perdoret kurdo dhe sic autorizohet nga Ortaku.

10.6 Gjuha e punes se Shoqerise eshte shqipja dhe anglishtja.

10.7 Ky Statut hyn ne fuqi ne ditën e regjistrimit tek Regjistri.

Ky Statut eshte shkruar ne gjuhen angleze dhe shqipe ne 10 kopje origjinale: 5 kopje ne gjuhen angleze dhe 5 ne gjuhen shqipe, dhe te dhjete tekstet jane te vleshme. Tekstet ne versionin anglisht dhe shqip jane nje dhe te njejte.

Data: 1 Qershor 1996

Deloitte & Touche Eastern Europe SA



Administratori
Trevor J. Wallinger

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOME E NOTEREVE TIRANE

Nr. 10001 Rep.

Nr. 2656 Kol.

VERTETIM

Ne Tirane sot me datën 1.10, perpara meje noteres se rrethit Tirane Shkollës Shqipe u paraqit personalisht z. Trevor Wallinger, per identitetin e te cilit u sigurova nga leter njkoftimi personal No 5464159, i cili deklaroi se sa siper eshte nje statut i pergatitur sipas vullnetit te tij te lire dhe te plote, dhe une notere e konfirmoj ate sipas ligjit.

Trevor J. Wallinger



[Handwritten signature]